



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-30350/24 datë: 20.11.2024



Npi – 01/362 datë: 20.11.2024

Bazuar në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr.28, datë 04.06.2008); Nenit 32, dhe 37 të Statutit të Komunës së Shitmes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës Nr.02/2015 të datës 28.12.2015; Si dhe në bazë të nenit 4 dhe 6 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi-01/155 të datës 27.04.2023, Kryesuesi i Kuvendit vendosi të bëjë këtë:


F T E S Ë

PËR MBLEDHJEN E -XI- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

E cila do të mbahet në sallën e Kuvendit më: 29.11.2024 (e premte) Në ora: 09:00h

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 31.10.2024,
2. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, (pas diskutimit publik)
3. Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-28. (pas diskutimit publik)
4. Propozim-Vendim Paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale,
5. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale,
6. Formimi i Grupit Punues për hartimin e Planit të punës dhe Orarit të mbledhjeve për 2025,
7. Informatë nga DSHMS (Me theks të veçante Kanceri i Gjirit).
8. Pyetje – Përgjigje.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-28277/24 datë: 23.10.2024



Npi – 01/351 datë: 31.10.2024

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 31.10.2024, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I Mbledhjes së -X-të, të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes,
mbajtur më datë 31.10.2024 (e enjte), në ora 09:00h, në sallën e Kuvendit.

Në mbledhjen e Kuvendit, kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, z.Rahman Jakupi, z.Lumni Amrush, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Rexhep Gashi dhe z.Reshat Mujota.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu; Të gjithë drejtorët e drejtorive komunale; Shefja e Kabinetit të Kryetarit, znj.Anita Kurti; Nga Zyra për Informim; znj.Vlora Hyseni dhe z.Albion Shabani; Zyrtarë i TI-së, z.Shpëtim Gashi; Asistente e Kryesuesit të Kuvendit znj.Gentiana Mehmeti; Nga OSBE-ja z.Mefail Mustafa; Nga Radio Zëri i Shtimes, z.Muhamet Hoxha;

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes, njoftoi Kuvendin me pikat e propozuara për këtë seancë, si vijon:

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.09.2024,
2. Raporti nëntëmujor buxhetor Janar-Shtator 2024,
3. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, (diskutim publik)
4. Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për dhënien e tokës komunale në shfrytëzim,
5. Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-01/313 për banim të përballueshëm sipas rekomandimit të MAPL-së Nr.020-618-5 dt.17.10.2024,
6. Propozim-Vendim për shpalljen e pronave të paluajtshme me interes të përgjithshëm,
7. Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-28, (diskutim publik)
8. Propozim-Vendim për themelimin e vendgjuetisë në territorin e komunës së Shtimes,
9. Pyetje – Përgjigje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

* Kuvendi i Komunës së Shtimes me 11 vota “Për” me 10 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstënim” miratoi rendin e ditës.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.09.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit, prezentë në mbledhje.

* Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 18 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstënim” miratoi Ekstrakt-Procesverbalin e Kuvendit nga mbledhja e mbajtur më 27.09.2024.

Pika 2

Raporti nëntëmujor buxhetor Janar-Shtator 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ia jap Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Përshëndetje. Sot po e prezantojmë para Kuvendit Raportin 9 mujor që e kemi si obligim ligjor nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Ligji për Financat Publike dhe Përgjegjësitë. Materialin e keni marrë dhe e keni lexuar, kështu që unë nuk do ta zgjati me detaje por do ti lexoj të dhënat sipas kodeve ekonomike dhe pastaj nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem (shih dokumentin).

z.Përparim Ramusa: Faleminderit për Raportin, ky është një raport real. Drejtor si është e mundur me pas një performance kaq të ulët të të hyrat vetanake. Në vazhdim lexoi nga raporti me shifra konkrete disa të dhëna dhe krahasoi me vitet paraprake.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Faleminderit për pyetjet. Sa i përket inkasimit të hyrave vetanake ne kemi arritur deri në 30 % me i grumbulluar, mirëpo duhet me pas parasysh që komuna e Shtimes i ka falur mbi 300.000 €. Në raport ne projeksonet i kemi realizuar 99.96%. Pjesa komplet e këtij projekti do të përfundon në muajin Nëntor.

z.Përparim Ramusa: Çka ka lidhje kjo me tatimin në prone kur është minus 81%?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Nëse shikojmë mbrapa, na del që kemi diferenca edhe më të larta. Në raport shihet qartë që ne projeksonet i kemi arritur në maksimum.

z.Muhamet Ademaj: Faleminderit për raportin. Raporti është real, dhe ka pjesët e tijë ku tregojnë realizimin e buxhetit sipas përqindjeve. Shihet se të hyrat vetanake në vitin 2024 në krahasim me vitin 2023 janë për 30% më pak, por e spjegoi drejtori pse. Ne jemi për miratimin e këtij raporti dhe do ta votojmë.

z.Rexhep Gashi: Faleminderit për raportin, që e bërë një elaborim. Sa i përket investimeve kapitale nuk jamë i kënaqur. Në vazhdim lexoi disa shifra në document lidhur me shpenzimin e buxhetit dhe bëri një pyetje, se pse jemi këtu me zero dhe çka ka ndodhur me frybilancin?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Të rekomandoj Rexhep për me lexuar kolonën pak më lartë ku spjegohet se përqindja është 97% e që kjo është në krahasim me mjetet e alokuara.

znj.Adelina Beqaj: Përshëndetje. Pytja ime është ku me lexu unë në raport për shpenzimet e drekave zyrtare edhe për shpenzimet për fushatë?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Merre dhe hynë në veb faqen e komunës dhe aty i sheh të gjitha shpenzimet të detajuara.

z.Asllan Beqaj: Përshëndetje. Sa për sçarim Pasqyrat financiare, bëhen një herë në vit. Këtu jemi duke diskutuar për raportet financiare të cilat bëhen katër herë brenda vitit ose çdo tre muaj. Për këtë raport me diskutuar është krenari, dhe unë personalisht jam shumë i kënaqur për shumë arsye. Realizimi i buxhetit me 77% konform planifikimit është sukses, dhe kjo duhet të shikohet si tërësi e jo në formë të ndarë.

z.Hamëz Tërshani: Më ka mbetë në krye ajo që e tha drejtori, ti je ekonomist i mirë, por ti e ke për detyrë me na spjeguar neve, e nuk është në rregull me reaguashu si tha edhe vetë

parafolsi lidhur me çështjen që e ngriti Rexha, sepse realisht edhe unë e pat andërmend që ta ngriti. Kërkoj që pak më shumë me qenë njerëzor, sepse sot je ti aty në atë pozitë e nesër është dikush tjetër, prandaj të lutem me u përgjigjë në atë që tha Rexha.

z.Asllan Beqaj: Kolegët nuk e kanë dëgjuar fare drejtorin çka ka thenë. Raport më të thjeshtë e më të mire nuk ka. Mirë që po bëni pyetje por nuk po e bëni ndonjë pyetje të rëndësishme. Drejtori tha shkoni në veb faqen e komunës dhe aty i gjeni të gjitha informatat në detaje.

znj.Adelina Beqaj: veç një përgjigje e mora ama për dreka-darka e udhëtime zyrtare nuk mora përgjigje.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Nuk është përgjegjësi e drejtorit me i mbajtur mend të gjitha shpenzimet. Për nëntëmujorin te zyra e kryetarit kemi një shumë simbolike prej 330 eurove.

z.Besnik Seferi: Është mirë që ta shohim veten para se të bëjmë akuza te drejtori. Po flasim për një raport ku kemi investime në komunën tonë rreth 20 milion euro dhe këto të mira duhet me i pa dhe me ju gëzuar secili. Ju po kapeni me një pikë ku fare nuk ka rëndësi. Po shihen në teren që janë duke u bërë shumë punë. Mendoj se e kemi një ndër raportet më të mira që ka pas komuna e Shtimes ndonjëher.

z.Rrahman Jakupi: Unë mendoj se askush nuk ka të drejtë me na vlerësuar neve. Adelina e bëri një pyetje për dreka zyrtare e ju jeni munduar me hjekë nga raporti termin dreka zyrtare duke thenë shpenzime të brendshme. Nuk është korrekte me thenë 300 euro për shpenzime të Kryetarit, sepse unë e kamë informatën se janë mbi 12000 euro, më mire thuani kërkonin në veb faqen e komunës. Është mirë me na mirë informu e jo me na keq informu sepse ne do ta zbulojmë.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Te raporti ku bëhet fjalë për shpenzimet te zyra e Kryetarit, në planin kontabël të ri, u është ndrruar emërtimi i disa kodeve buxhetore, dhe nuk është më dreka zyrtare.

z.Asllan Beqaj: E para puna e kamrierit është e shëndetshme dhe e mire e nuk duhet me u keqtrajtu e keqinterpretu sepse i nënqmoni shumë punëtorë të qytetarisë. Ju po quditeni me këto pak shpenzime për dreka zyrtare, sepse ju jeni mësuar me shku jashtë Kosovës zyrtarisht e me kqyr ndeshje futbolli, dhe me shpenzu shumfish edhe me marr mëditje.

z.Hamëz Tërshani: Krahsimet me vitin 2018 është jo njerëzore. 300 euro shpenzime të Kryetarit nuk ka logjikë. Kryetari ka qenë në Gjermani, kështu që shpenzimet e Kryetarit normalisht që për mua kanë logjikë, por nuk është normale tendenca për me i mshefë ato. Nuk bënë me rrejtë se Kryetari i ka pru 20 milion euro investime, kjo është arrogancë dhe nuk është në rregull.

z.Asllan Beqaj: Nuk e di se si e kupton ti Hamëz arrogancën por arrogancë është me i bë pyetje drejtorit dhe me i thënë kthema përgjigjen ashtu qysh dua unë.

z.Hamëz Tërshani: Arrogancë, thash do të thot është gabim me i bërë 300 euro shpenzime sepse është dashur me i bërë 3500 euro psh. kjo është normale kështu e thash, mirpo tendenca për me mshefë thash është joserioze.

z.Reshat Mujota: Raporti bëhet edhe në bazë të hyrave e jo veq në bazë të shpenzimeve. Shqetësimi është te përqindja me minus psh. -88% tash meqenëse jemi me minus a ka humbur besimi i qytetarëve te kjo qeverisje, a çka u bë, sepse u krenojshi më heret. U fol 300 euro shpenzime te Kryetari këro shpenzime a janë shpenzime udhëtimit a çka meqenëse ka qenë në Gjermani?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Shpenzimet janë të ndara edhe për udhëtime zyrtare jashtë vendit. Të gjitha shpenzimet te zyra e Kryetarit janë 2349 euro. Këto i gjeni te faqja e 7 e raportit.

z.Reshat Mujota: Faqe 7 te cila kolonë?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Te tabela numër 3.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Përshëndetje, dua të jap një sqarim lidhur me shpenzimet, sepse mu përmend emri disa here. Nuk ka Kryetar Komune në Kosovë që ka shpenzime më pak se sa unë, sepse as unë e as kushdo tjetër nuk ka marrë asnjë mëditje për udhëtime jashtë shtetit. Unë kam qenë në Gjermani dhe e vërteta është se unë kam fjetur ose te shoku im ose te familjarët e mi për me i kursyer 4-500 euro. Prandaj po ju them se kursimi, morali, dhe dinjiteti janë pikat e

mija më të mira dhe më të fortat, prandaj me provuar me akuza ndaj meje në këto pika nuk funksionon fare sepse shifrat dhe argumentet janë kokfortë. Por për ju e kuptoj që e keni të vështirë që ta kuptoni, sepse kursimin nuk e keni pas asnjëher as në mendjen e juaj.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Projekcioni është në raport me realizimin rreth 15000 euro, dhe deri në fund të vitit mundet me ardhë deri në qind për qind. Është mire me lexuar raportin para se me ardhur në seancë, dhe me ditë e me parashtruar edhe pyetjen për drejtorin. Në vazhdim Konstatoi Kuorumin prej 17 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 6 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” miratoi Raportin Buxhetor të Komunës së Shtimes për periudhën Janar-Shtator 2024.**

Pika 3

Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025. (diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Kemi Rekomandime nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe nga Komiteti për Komunitete të cilat i kanë rekomanduar Kuvendit miratimin e vendimit që Draft Rregullorja për taksa të shkojë në diskutim publik. Para se ta hapi diskutimin për këtë pike, fjalën për prezantimin e kësaj pike ja jap Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Siç e tha edhe Kryesuesi, ky draft ka me shku në diskutim publik ku do të mund ta japin kontributin secili, dhe pastaj drafti vjen prap në Kuvend për miratim. Në këtë draft nuk ka asnjë ndryshim të propozuar nga drejtoritë. Ju ftoj që ta votoni, propozimin për diskutim publik.

z.Besnik Seferi: Edhe ne jemi pro që të shkojë në diskutim publik.

*** Kuvendi Komunës, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria Komunale për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Pika 4

Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për dhënien e tokës komunale në shfrytëzim

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Edhe për këtë pike e kemi Rekomandime nga Komiteti për Politikë dhe Financa ku i rekomandon Kuvendit miratimin e vendimit për formimin e Komisionit për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale. Kërkoj propozimet e juaja për formimin e këtijë Komisioni.

z.Rexhep Gashi: Unë mendoj se në këtë Komision duhet të jenë disa anëtarë që kanë përvojë. Ne e kemi këtu present një anëtarë që e njeh punën e komisionit dhe i vlerëson operatorët. Unë pra e propozoj Reshat Mujotën në këtë Komision.

z.Muhamet Ademaj: Në emër të pozitës ne e propozojmë Aran Lubovcin.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Nga ekzekutivi i kemi këta emra, njëri është jurist nga Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Shqiprim Hyseni, dhe tjetri është nga Zyra Ligjore Halil Kurtishi. Ndërsa nga Shoqëria Civile po presim me na ardhur një emër.

z.Përparim Ramusa: Nuk është në rregull për anëtarin nga shoqëria civile, ndërsa për anëtarët nga ekzekutivi nuk kemi vërejtje.

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ: Përshëndetje. Unë mendoj se ata (shoqëria civile) duhet me u taku dhe me vendosë për një emër, dhe pastaj e inkorporojmë në vendim. Unë nuk e di që ka ndonjë arsye ose ndonjë mekanizëm që me vendosë kundër atijë emri që e propozojnë ata si përfaqësues të shoqëris civile.

z.Reshat Mujota: Ne nuk jemi kundër, por me na pyet neve dikush a e keni votuar anëtarin e pestë nuk mund ti themi se po. Unë jam për me shty për mbledhjen e radhës, dhe me votu pastaj komplet.

z.Përparim Ramusa: Nuk mund të folni për transparencë kur nuk e keni emrin e personit nga shoqëria civile. Edhe unë propozoj për me u shty për mbledhjen e radhës.

z.Rrahman Jakupi: Ky Komision është i rëndësishëm, dhe anëtarët duhet të jenë profesionist. Ne si opozitë po kërkojmë emër të anëtarit të pestë nga shoqëria civile. Në kuptimin ligjor nuk është në rregull. Praktikë janë të ndryshme.

z.Besnik Seferi: E dëgjova parafolsin kur tha se janë mbrojtë interesat e shoqërisë civile. Ky person duhet me ditë rëndësinë e OJQ-ve sepse ka punuar aty sikurse edhe unë. Praktikë tregojnë se shumë vendime në këtë Kuvend përpara janë marrë pa e pasë emrin e anëtarit nga shoqëria civile. Kjo është e vërteta. Në fillim në këtë pike e aprovuam me futë në rendin e ditës e tash po thuani me shty.

z.Kadri Emini: Në KPF-ë keni thenë se ky vendim është i vonuar, e tash po propozojnë për me u shty. Unë nuk po e shoh të arsyeshme për me u shty. Ky Komision nuk vendosë por Kuvendi do të vendos për pronat. Edhe unë jamë për me riplotësu në mbledhjen e radhës. E formojmë si Komision dhe në mbledhjen e radhës e votojmë formalisht vetëm emrin e anëtarit të shoqërisë civile.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Nuk mund ta formojmë një Komision me numër qift prej 4 anëtarëve. Ekzekutivi ka mandat me i propozuar emrat nga administrata komunale që i kemi. Shqiprim Hyseni dhe Halil Kurtishi, ndërsa nga opozita Reshat Mujota dhe nga pozita Artan Lubovci.

z.Asllan Beqaj: Ne nuk mundemi me ua kushtëzuar atyre, se kur me zgjedhë dhe me na e sjellë emrin e tyre. Ne e votojmë vendimin për formimin e Komisionit, dhe OJQ-të e binë emrin e tyre dhe inkorporohet në vendim.

z.Rexhep Gashi: Kryetari i ka pru emrat e anëtarëve të Komisionit nga ekzekutivi mirë, por i kemi 5 anëtarë të Komisionit, dhe emrin e anëtarit të pestë nuk e kemi emrin se cili është anëtar i pestë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Sqaroi, se e kemi emrin, shoqëria civile, dhe ata e sjellin emrin që e zgjedhin vetë.

z.Lumni Amrushi: Përshëndetje. U diskutua gjatë, faji po mbetet jetim, po duhet me bërë tejkallim të rregullores. Unë mendoj se është dashur me pas një thirrje publike, dhe e kishe kry me këtë emër, dhe po ta kishe kry me kohë tash e kishim votuar dhe nuk do kishte asnjë problem. Por tash po duhet me tejkallu rregulloren. Unë kërkoj që mos të përsëritet më kjo, dhe mos të vihet në Kuvend pa emrat komplet.

z.Reshat Mujota: Qysh me nejtë edhe unë në këtë Komision, pa qenë edhe anëtar i pestë i Komisionit. Me 4 anëtarë sigurisht që kthehet vendimi prapa nga MAPL-ja për rishqyrtim. Nëse nuk ka emër nga shoqëria civile ose ta bëjmë dikend nga Kuvendi ose ta shtyjmë për mbledhjen e radhës.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Brenda 7 dite shkojnë vendimet e Kuvendit në MAPL-ë dhe atje ne do ta qojmë vendimin me 5 emra të anëtarëve të Komisionit. Në vazhdim Konstatoi Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 19 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" miratoi vendimin për formimin e Komisionit vlerësues për shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim, pronën e paluajtshme komunale, i përbërë prej 5 anëtarëve si vijon: 1. Halil Kurtishi – nga ekzekutivi komunës. 2. Shqiprim Hyseni – nga ekzekutivi komunës. 3. Artan Lubovci – nga Kuvendi (pozita). 4. Reshat Mujota – nga Kuvendi (opozita). 5. Imer Tershana – nga organizatat joqeveritare, (Klubi i Biznesit – Shtime).**

Pika 5

Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-01/313 për banim të përballueshëm sipas rekomandimit të MAPL-së Nr.020-618-5 dt.17.10.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Këtë vendim Npi-01/313 dt.27.09.2024, për ndarjen e parcelës për banim të Përballueshëm dhe Social në Komunën e Shtimes e kemi votuar në mbledhjen e kaluar të Kuvendit, MAPL-ja përkatësisht MMPHI-ja, e ka kthyer në rishqyrtim dhe na ka

rekomanduar që të plotësohet baza ligjore e këtijë vendimi edhe me nenin 25 i Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit”, sipas rekomandimit të MMPHI-së, Nr.6498-2/24 dt. 17.10.2024. Hpi diskutimin për këtë pikë. Meqenëse diskutime nuk ka atëherë Konstatohet Kuorumi prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 19 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi vendimin për plotësimin e bazës ligjore të vendimit të Kuvendit me numër Npi-01/313 të datës 27.09.2024, si vijon: “Nenin 25 i Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit”, sipas rekomandimit të MMPHI-së, Nr.6498-2/24 dt. 17.10.2024.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Pas kësaj pike po shkojmë në pauzë të drekës në ora 11:32h dhe kthehemi në mbledhje në ora 13:30h.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Me këtë rast të pauzës ju ftoj të gjithëve që bashkërisht të shkojmë dhe ta qesim gurthemelin për fillimin e punimeve në rrugën Petrovë përkatësisht Luzhak – Rancë, një investim mbi 400.000 euro.

Pika 6

Propozim-Vendim për shpalljen e pronave të paluajtshme me interes të përgjithshëm

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Ky propozim ka kaluar nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe nga Komiteti për Komunitete dhe i kanë rekomanduar kuvendit që ta aprovojë. Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ: Përshëndetje. Materialin për këtë propozim e keni marrë. Bazën Ligjore e keni pa, dhe sot e kemi sjellë këtë propozim në Kuvend për miratim. Pronat që do të shpronësohen për hapjen e rrugës së re që i lidh rrugën “Villiam Voker” me rrugën “12 Qershori” i keni të gjitha në propozim-vendim. Ju ftoj që ta votoni, dhe nëse ka ndonjë pyetje jam këtu që të përgjigjem.

z.Muhamet Ademaj: Ne si grup parlamentar AKR-LDK e përkrahim vendimin për hapjen e kësaj rruge të re, sepse kjo rrugë është në interes të gjithë qytetarëve.

z.Rexhep Gashi: Ne nuk mund të themi se jemi kundër sepse është në interes të qytetarëve, por mënyra është e pa pranueshme, sepse ju po punoni me bagera e këtu e keni prurjen e vendimit për miratim. Këto prona nga rruga “Villiam Voker” deri te rruga “12 Qershori” janë prona private që duhet të shpronësohen, a po e dëmtoni buxhetin, sepse pikërisht këtu është keqmenagjim, edhe këtu edhe në Pjetërshicë.

z.Përparim Ramusa: Për këtë pikë kemi diskutuar gjatë edhe në KPF-ë. Pajtohem me parafolësin, sepse çdo rrugë është e mirëseardhur. Sot po punohet aty e ne po flasim për shpronësim. Ne nuk mund të dalim kundër rrugës, mirëpo me ndodhë e me thane sot Kuvendi jo, atëherë si do të ja bëni ju. Unë nuk jam kundër hapjes së rrugës dhe kamë me e votuar “për” por po i shkelni procedurat.

z.Reshat Mujota: Është e moralshme, njerëzore e ligjore që një her me i shpronësuar pronat e pastaj me ja filluar punimeve aty. Pse nuk po i bëni me kohë? Unë jamë “për” por procedurat ju kisha lutur me i bërë me kohë, sepse duhet me qenë transparent. Unë mendoj se duhet me mbajtë takim me banorët e pronave dhe me pas një procesverbal dhe me pa nëse ata banorë janë “për”.

z.Besnik Seferi: Edhe ne si grup parlamentar i LVV-së jemi “për” miratimin e këtijë vendimi ashtu siç ka ardhur në Kuvend.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatohet Kuorumi prej 18 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* Kuvendi i Komunës, me 17 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm, Ngastrat Kadastrale si vijon:

Nr.	Numri i ngastrës Kadastrale	Sipërfaqja m ² :	Zona Kadast:	Kualiteti i Klasës:	Prona në emër të: ose (Bashkëposedim)
1	P-72809093-01744-0	609	Shtime	Tokë Ndërtimore-Oborr	Ahmet Ramadani Muhamet Ramadani
2	P-72809093-01745-0	2724	Shtime	Arë - Klasa e 2/ Bujqësore Arë - Klasa e 3/ Bujqësore	Ahmet Ramadani Muhamet Ramadani
3	P-72809093-01747-2	600	Shtime	Arë - Klasa e 2/ Bujqësore	Imri /Bislim/ Shala Agim /Bislim/ Shala Fatmir /Bislim/Shala
4	P-72809093-01747-3	1038	Shtime	Arë - Klasa e 2/ Bujqësore	Rifat /Faik/ Ramadani
5	P-72809093-01747-4	771	Shtime	Arë - Klasa e 3/ Bujqësore	Mustaf /Azem/ Fazlija
6	P-72809093-01747-5	745	Shtime	Arë - Klasa e 3/ Bujqësore	Kadri /Azem/ Fazliu
7	P-72809093-01747-8	360	Shtime	Arë - Klasa e 3/ Bujqësore	Enes /Fehmi/ Fazliu
8	P-72809093-01747-9	346	Shtime	Arë - Klasa e 3/ Bujqësore	Arton /Fehmi/ Fazliu
9	P-72809093-01773-1	72	Shtime	Tokë Ndërtimore - Shtëpi	Adem /Hysen/ Bleta
10	P-72809093-01773-2	49	Shtime	Tokë Ndërtimore - Shtëpi	Adem /Hysen/ Bleta
11	P-72809093-01773-3	582	Shtime	Arë - Klasa e 1/ Bujqësore Tokë Ndërtimore - Oborr	Adem /Hysen/ Bleta
12	P-72809093-01774-4	2382	Shtime	Arë - Klasa e 2/ Bujqësore	Adem /Hysen/ Bleta
13	P-72809093-01775-0	424	Shtime	Tokë Ndërtimore - Shtëpi Tokë Ndërtimore - Oborr	Adem /Hysen/ Bleta
14	P-72809093-02929-1	4585	Shtime	Arë - Klasa e 2/ Bujqësore	Gani /Hamit/ Pajaziti
15	P-72809093-03010-0	4976	Shtime	Arë - Klasa e 2/ Bujqësore Arë - Klasa e 3/ Bujqësore	Bajrush /Faik/ Ramadani

Pika 7

Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-28, (diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Mimoza Salihu-Qeriqi. **znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, DSHMS:** Përshëndetje. Ne e kemi diskutuar edhe në KPF-ë dhe meqenëse ka me shku në diskutim publik dhe ka mundësi me dhënë komentet e veta secili atëherë nuk po e zgjasim sot në trajtimin e materialit, por ju ftoj që ta votoni vendimin për diskutim publik.

znj.Albana Podvorica: Përshëndetje, për personat me aftësi të kufizuar unë po rekomandoj që me i plotësuar kushtet për me pasë qasje të lirë dhe të mjaftueshme në të gjitha institucionet, qofshin ata me karroca, shurdhë-memec ose kategori tjera të tyre, sepse pikërisht në këtë strategji duhet të parashihet mundësia për një qasje më të lehtë të tyre, me qëllim të integrimit në shoqëri.

z.Besnik Seferi: Mendoj se është bërë një punë e mire, me këtë draft-strategji. Edhe unë edhe të tjerët bashkërisht është mire që po bëjmë diqka për integrimin e kësaj kategorie të personave me aftësi të kufizuar. Në Shtime kemi rreth 294 persona me aftësi të kufizuar. Nuk do të lëshohem në diskutim më të gjatë meqenëse ka me shku në diskutim publik dhe aty do ta japim kontributin tonë.

z.Përparim Ramusa: E përgëzoj drejtoreshën për një plan të tillë. Këta persona janë besoj edhe më të mirë se ne, prandaj unë personalisht e përkrahu këtë draft-strategji që të shkojë në diskutim publik.

z.Kadri Emini: E përkrahu propozimin e Albanës. Kërkoj nga ti drejtoresh që neve anëtarëve të Kuvendit me na i dërguar ftesat me e-mail, por edhe mundësisht ftesa për diskutim publik me ju shku secilit person me aftësi të kufizuar.

z.Reshat Mujota: Faleminderit për këtë draft-strategji dhe plan veprimi. Ju lusim drejtoresh që ky plan mos me mbetur veq në letër, por ju si ekzekutiv me ju dhënë përparësi personave me aftësi të kufizuar në konkurimin e tyre në ndonjë vend pune.

znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, DSHMS: Ju falënderoj për diskutimet dhe pyetjet e juaja, por edhe unë po e kërkoj ndihmën e juaj qoftë në identifikimin e personave me aftësi të kufizuar, qoftë edhe në ndihmën që mund tu japim në qfarë do forme kësaj ketegorie te shoqërisë sonë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 17 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

Kuvendi Komunës, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Strategjinë dhe Planin e Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-2028. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

Pika 8

Propozim-Vendim për themelimin e vendgjuetisë në territorin e komunës së Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Gojart Bajrami.

z.Gojart Bajrami, DBPZHR: Përshëndetje. Sot e kemi sjellë në Kuvend për miratim Propozim-Vendimin për themelimin e vendgjuetisë në territorin e komunës së Shtimes. Sipas Ligjit Nr.02/L-53 për Gjuejinë, jemi të obliguar për me përcaktu vendgjuetinë e përbashkët, me vendim të Kuvendit, sipas kriterëve që i parasheh ky ligj. Materialin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, prandaj unë nuk do ta zgjati shumë, por nëse ka ndonjë pyetje do të bëj përpjekje që të përgjigjem. Ju ftoj që ta votoni këtë propozim-vendim.

znj.Adelina Beqaj: Faleminderit drejtor për këtë propozim-vendim, mua po më intereson me ditë?

z.Rexhep Gashi: Nuk e kamë të qartë, këtu në fillim të dokumentit ku keni thënë në fshatin Zotaj janë 400 hektar me pyje, ndoshta keni bërë gabim teknik.

z.Muhamet Ademaj: E falënderoj drejtorin për këtë propozim-vendim që e ka sjellë në Kuvend. Ne si grup parlamentar AKR-LDK do ta përkrahim dhe do ta votojmë.

z.Reshat Mujota: Ka pas edhe përpara vendgjueti. Mirëpo mua po më interesojnë këto statistikat për llojet dhe numrin e kafshëve të egra në komunën tonë, unë vërtetë nuk e di se si janë marrë këto statistika, far eksperti duhet të jetë ai që i ka numëruar, kështu që po e kërkoj një sqarim nga drejtori se mbi bazën e kujt janë dhënë këta numra. Po kërkoj sqarim me arsyetimin se nuk dëshiroj që të dalim qesharak me këto statistika.

z.Përparim Ramusa: Faleminderit për propozim-vendimin, meqenëse po bëhet fjalë këtu për 14 hektarë, është mirë që me na tregu drejtori se për far prone po bëhet fjalë këtu, a janë prona publike apo private?

z.Gojart Bajrami, DBPZHR: Informatat për këtë propozim-vendim i kemi marrë nga zyrtarët tanë por edhe nga gjahtarët. E dimë që shifrat mund të janë të pa sakta por këtë të dhëna janë vetëm në fazën fillestare, dhe do të përpunohen. Vendet e ndaluara për gjueti janë të parapara me nenin 24 të Ligjit për Gjuejinë Nr.02/L-53 si vijon:

a) Zonat e natyrës posaçërisht të mbrojtura në të cilat me aktin e shpalljes si zonë e mbrojtur apo ndonjë akt tjetër të veçantë është ndaluar gjuetia si: Rezervati strikt i natyrës. Parku nacional, Monumenti i natyrës, Zona menaxhuese e habitateve ose e llojeve të mbrojtura. Peizazhi i mbrojtur, Zona e mbrojtur e resurseve natyrore. b) Tokat brenda 300 metrave nga vendbanimet, rrugët kryesore publike, ndërtesat fetare, shkollat, dyqanet ose zyrët. c) Varrezat, aeroportet, bazat ushtarake dhe oborret e mbyllura. d) Fidanishtet, pemishtet, vreshtat dhe kopshtet të destinuara për prodhim intensiv në sipërfaqe deri në 100 ha nëse janë të rrethuara me rrethojë e cila e pengon migrimin natyror të kafshëve të egra.

znj.Adelina Beqaj: A i keni pyetur pronarët e pronave private se a lejojnë gjuetinë në pronat e tyre?

z.Gojart Bajrami, DBPZHR: Sqaroj, se kjo hapsirë e paraparë me vendim të Kuvendit është vendgjueti e përbashkët e cila do tu ipet në menagjim, personave fizik ose juridik, përmes procedurës së (koncesionit ose dhënjes me qera) duke i zbatuar procedurat e tenderimit, përkatësisht ofertimit publik, konform dispozitave ligjore.

Komuna e Shtimes do të lidhë kontratë me përfituesin e tenderit për menagjimin e vendgjuetisë së përbashkët në Komunën e Shtimes. Kontrata duhet të jetë e bazuar në këtë vendim si dhe duhet të përmbajë përveq të tjerave edhe elementet e parapara të nenit. 36, 37, dhe 38 të Ligjit për Gjuetinë Nr.02/L-53.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 18 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

Kuvendi i Komunës, me 16 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim" miratoi, Vendimin për caktimin e Vendgjuetisë së përbashkët në territorin e komunës së Shtimes, në sipërfaqe prej 13.450,8 hektar, duke u kufizuar me kufijt administrativ të Komunave, Ferizaj, Lipjan dhe Therandë (Suharekë).

Pika 9

Pyetje - Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Ademaj: Pyetje për drejtorinë e Urbanizmit, Kadastër dhe Gjeodezi, kur do të fillojë trotuari në rrugën "Skender Salihaj" dhe "Hyre Emini"?

z.Rexhep Gashi: Pyetje për DPUKLGJ-në, drejtor a është pranue teknikisht rruga Godanc-Gjyrvoc, saktësisht të rruga "Ibrahim Rugova" që kalon prej Godancit? Dhe pyetja tjetër për DSHP-në, drejtor, këto pikët e stacionit të autobusave a janë pranuar teknikisht, sepse unë i di dy raste të cilat gjatë punësimit janë me xham të krisura, dhe nëse janë pranuar teknikisht si ka mundësi me u pranuar ashtu me xhama të krisura?

z.Besnik Seferi: Unë realisht nuk kam pyetje. Du ta di a është e planifikuar edhe çështja e rrugës "Shefket Muhadini" po ashtu edhe rruga "Janina" në Davidovë? Po ashtu e kam edhe një shqetësim që ka të bëjë me rregullimin e rrugës magjistrale Belinc-Carralevë ku vërtet u bë një kaos i madh aty dhe është demoluar ajo rrugë e nuk e di ku është problematika aty, ne e kemi për detyrë me shprehë si shqetësim sepse ajo rrugë po paraqet rrezik të madh, prandaj i rekomandoj drejtorisë të merr hapa konkret për rregullimin e kësaj rruge sa nuk është bërë ndonjë dëm i madh. Pyetja tjetër ka të bëjë me planifikimin më konkretisht asfaltimin e rrugës "Lasgush Poradeci" në Muzeqinë në një segment të saj meqenëse, e kemi një bashkëqytetarë tonin Hasan Bajrami, i cili thotë se ka bërë një kërkesë të vazhdueshme të drejtorisë përkatëse për të cilën gjë duhet me ja dhënë një përgjigje se a do të bëhet apo jo. Pyetje për DSHP-në, drejtor si është duke qëndruar situata e rregullores apo në Komunën e Shtimes?

znj.Adelina Beqaj: Pse ikën anëtarët e kuvendit të pozitës ku shkuan, a i dinë interesat e qytetarëve? Edhe kjo është pyetje e drejtuar pozitës, na krejt ktu jena. Pyetje për DSHP-në pse nuk po mirëmbahen trotualet nëpër fshatra? Për deri sa keni kontraktuar kompani. Trotualet nuk po mirëmbahen janë të mbushura me bari. Pyetja tjetër e përsëritur për DPUKLGJ-në, çka po ndodhë me shtëpinë e të pames në fshatin Petrovë?

z.Përparim Ramusa: Unë nuk dua me pyet kurgjë ekzekutivin por dua me të pyet ty Besnik, a je ti ai që lufton prej 2017 për ç'do mbledhje thojshë që pika pyetje-përgjigje me hy e para e sot je palu këtu edhe voton gjithë që kjo pikë me qenë e fundit. E dyta Besnik unë prita prej teje me pyet ekzekutivin konkretisht për problemin e Rashincës, që 220 nënshkrime janë mbledhë që janë kundër qatit projekti, ti ktu vjen me ba populizëm edhe me postu një video qaty kishe po bej punë. Besnik tu kisha lutë banë pak ma shumë për këtë punë.

z.Besnik Seferi: Mua më bëri pyetje Përparimi, dhe unë duhet ti përgjigjem. Po përgjigjem në pyetjen e dytë së pari. Po ndihem mirë që edhe ju e keni marrë shprehinë time për me postuar video nëpër Facebooka, kjo është diçka e mirë. Sa i përket populizmit unë realisht shumicën e kërkesave që i kam bërë unë shumica veq janë realizuar. Pajtohem plotësisht me atë të Rashincës që ndoshta është një prej pyetjeve që është dashur me pyet e që tash e shfrytëzoj rastin për me pyet është çështja e ujësjellësit në fshatin Rashincë. Realisht për këtë çështje edhe unë i kam shqetësimet e mija, ndoshta për faktin atje janë disa banorë të pa kënaqur me

furnizimin me ujë për pije, pyetja për drejtorinë është se ku është dhe si është projekti i ujësjellësit të fshatit Rashincë? Dua një pyetje konkrete drejtor.

z.Përparim Ramusa: Besnik njëri prej faktorëve që nuk e la me hy në rendin e ditës Ujësjellësin e Rashincës je ti, se votove kundër që me hy në rendin e ditës.

z.Reshat Mujota: Si shqetësim por edhe si kërkesë, për DKA-në shkolla "Emin Duraku" paralelja në fshatin Belinc ka probleme me nxemjen dhe ka shqetësime të prindërve që ose me gjet një zgjidhje për nxemje me energji elektrike me ndonje termo të rrymës ose zgjidhje tjetër? Kanë thënë se kalldaja ka problem me pompen dhe nuk po funksionon. Pyetja e dytë është për DSHP-në pyetje po bëj ka 5-6 her por përgjigjet nuk i kam marrë. Pyetje konkrete Deponitë ilegale kanë evalou në gjitha tokat bujqësore sidomos në teritorin e Shtimes, ka banorë që edhe kanë bërë fjalë me njerzit duke hedhur mbeturina, jo vetëm qytetarë por ka edhe prej Kompanive. Dmth. toka e bukës po shëndrrohet në deponi ilegale të mbeturinave. Pyetjen tjetër e kam për DZHE-në për disa rrugë të arave në fshatin Mollopolc, ende nuk kanë filluar dhe nuk ka asnjë lëvizje, kurë do të fillojnë punimet? Janë të interesuar banorët ta dinë. Kisha dashur konkretisht përgjigje direkte me ma dhënë e jo me shkrim. Ndërsa sa i përket DSHP-së përgjigjen me ma kthy edhe me shkrim.

znj.Albana Podvorica: Pyetje për DPUKGJ-në, te rruga "Skender Salihaj" afër shkollës "Emin Duraku" sa kam informata drejtor, ende nuk ka trotuar, kur do të bëhet rregullimi i trotuarit, këtë shqetësim e kanë edhe shoqëria civile, a do të bëhet rregullimi i trotuarit këtë vit apo kurë?

z.Lumni Amrushi: Lidhur me ate që tha Besniku se shumica e kërkesave janë kryer, amo Besnik punët po kryhen në mënyrë selektive. Kam unë pyetje konkrete Besnik, kur do të përfundojë palestra në fshatin Pjetërshticë? Për drejtorinë e Arsimit, oborrin e shkollës, rrethojen e shkollës shkoj mandati asnjë mirëmbajtje nuk ja kanë bërë? E mos të flasim për brenda shkollës. Pastaj kur do të përfundon një Kazermë Muze në fshatin Pjetërshticë? Shkronjat e UÇK-së janë të parat në nivel vendi dhe tash janë bërë të vjetra, aty ka munguar gjithçka deri tash. Kur do të bëhet pastrimi i lumit përmes fshatit që nuk është bërë asnjëherë? Kur do të bëhet renovimi i atyre rrugëve që siç është rruga "Idriz Ajeti" që e lidhë fshatin Pjetërshticë me fshatin Krojmir?

znj.Besartë Musliu-Spahija: Faleminderit për fjalën Kryesues, atëherë pyetja ime është për DSHP-në, për rrugën "Emrush" dhe rrugën "Selim Selimi" a do të bëhet ndriqimi në këto dy rrugë? Pyetja e dytë është për DPUKGJ-në, pyetje nga banorët e lagjeve "Londra", "Berlini", "Parisi" e tjerë kur do të.....? Pyetja tjetër është për DKA-në se pse nxënësit parashkollor të paraleles së ndarë në Belinc janë privuar të shkojnë në shkollën "Emin Duraku" në Shtime?

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Përsëritje, faleminderit Kryesues, për shkak të agjendës nuk mund të qëndrojë gjatë dhe desha me i dhanë disa përgjigje. Pyetje u bënë për ujësjellësin në fshatin Rashincë, ku më shumë ka tentim për me u politizu, se sa që ja don të mirën ujit dhe Rashincës. Ne kemi pas takim me disa persona që i kanë ngre shqetësimet e tyre gjoja për faljen e fondeve. E vërteta është që atje po ndërtohen përmes një projekti të përbashkët që e kemi Komuna e Shtimes me KRU "Prishtina", edhe dy Puse të reja dhe një impijant të grumbullimit dhe trajtimit të ujit, ku do të shtohet kapaciteti i ujit prej 20 litrave në sekond sa ishin shtohen edhe 20 litra për sekond, dhe kapaciteti i përgjithshëm do të jetë 40 litra për sekond, me qka për komplet fshatrat e rrafshit do të zgjidhet çështja e ujit të pijes. Ky është një lajm i mirë, i cili duhet me u prit mirë nga të gjithë. Këtë përzgjedhje dhe këtë projekt e ka bërë vetë KRU "Prishtina" si menagjuese e ujësjellësit me ingjinjerët dhe ekspertët e vetë. Në realisht nuk mund të diktojmë në këtë fushë kur ajo ka mbi 50 ekspert të ujit, dhe ne ti tregojmë se ku ka rezerva nëntoksore të ujit. Kte ua kam treguar edhe atyre banorëve të fshatit Rashincë që janë shqetësuar. Ekspertët e kompanisë e thonë se uji do të merret në një thellësi nën 20 metra thellësi, e deri në 40 metra. Uji i ujësjellësit nuk ka asnjë lidhje me ujërat të ashtuquajtur sipërfaqësor të puseve private që mund të jenë nga 2 deri 8 metra. KRU "Prishtina" garantojnë të gjithë banorët e fshatit por edhe të tjerët se shtimi i kapaciteteve me pusët dhe impijantin nuk kanë asnjë ndikim lidhur me shqetësimet që i paraqesin ata, kte po e them që ta dëgjojnë edhe të

gjithë qytetarët e fshatit Rashincë por edhe më gjerë. Ne e kemi për detyrë që të gjitha familjeve në komunën tonë me u sjellë ate që është elementare pra ujin e pijes. Ky është një projekt mbi 280 mijë euro. Po ashtu vitin e ardhshëm ne do të fillojmë me shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit nga burimi për ç'do familje të fshatit Pjetërshticë. Kështu që me këto fonde 500 mijë euro për fshatin Pjetërshticë dhe me 280 mijë euro për fshatrat e rrafshit, ne mendojmë që çështja e ujit të pijes që ishte problem i madh 25 vjeçar në komunën e Shtimes, përfundimisht do të zgjidhet. Edhe një herë u bëj thirrje të gjithë banorëve të fshatit Rashincë që mos të shqetësohen sepse ka analiza profesionale nga Injinerët që shpimet nuk do të ndikojnë fare në bunaret e tyre për të cilat po shprehin shqetësim. Nëse ka pakësim të ujit në bunaret e tyre kjo nuk vjen si pasojë e puseve të ujësjellësit por si pasojë e ndryshimeve klimatike që kanë ndikim në përgjithësi.

z.Rexhep Gashi: Jemi te pika e rendit të ditës pyetje-përgjigje, na në fillim kërkuam që të futet në rendin e ditës çështja e ujit në lidhje me banorët e Rashincës, ndërkohë që Kryetari na dha një sqarim, a ka mundësi ti bëj pyetje Kryetarit? Kryetar ku i kan bërë këto matje, ku unë nuk dyshoj te matjet e shtetit, por unë dyshoj te periudha kohore që e kanë matë, dhe për këtë a keni pas paraprakisht para se të fillojnë punimet për hapjen e këtyre puseve edhe hapja e kanaleve për shtrirjen e tubacionit për ujësjellës a keni pas takim me banorët e fshatit Rashincë?


Kryetari, z.Qemaj Aliu: Unë nuk është se ja kam shikuar afatin e skadencës të atij projekti. Kështu që unë nuk e kam fare dyshimin në kapacitetet profesionale të KRU "Prishtina", sepse kjo është një nga KRU-të më të mëdhaja në Kosovë, i ka ekspertët e vetë. Ata e kanë një projekt të detajuar i cili tregon që rezervat ujore nëntokësore më të mëdha në komunën e Shtimes janë pikërisht në zonën të fshatrat Gllavicë e Rashincë. Ju e dini që aty janë disa prona publike në të cilat do të bëhet shpimi. Sa i përket takimit me qytetarë, për hirë të vërtetës ne nuk kemi pas takim me qytetarë ekskluzivisht vetëm për këtë çështje, sepse kemi konsideru se ai është një projekt profesional i mirëfilltë i KRU-së në interes kryesor të banorëve atje, dhe këto puse ekzistuese edhe ato që do të bëhen të reja nuk e cenojnë në asnjë formë askend. Më vonë ka dalë ky shqetësimi nga banorët e fshatit Rashincë, por unë edhe një herë i garantoj jo mbi bazën e njohurive të mija por mbi bazën e sqarimeve që mi kanë dhënë ekspertët e KRU "Prishtina". Aty janë ujërat nëntoksor ku uji do të merret nën thellësinë e 20 metrave dhe kjo ujëra nëntoksore nuk mund ti ndikojnë këto ujrat horizontale që i mbushin pusët private të banorëve. Nëse shfaqet nevoja ne do të shkojmë dhe ti takojmë banorët një nga një, unë dy herë jam takuar me mbi 20 qytetarë të fshatit Rashincë, ku edhe ua kemi shpjegju kështu që e thash më parë. Kjo po bëhet në radhë të parë për të mirën e fshatit Rashincë, por pastaj edhe të gjitha fshatrave të rrafshit, madje edhe qytetit të Shtimes e më gjerë me lidhjen e gypave që do të bëhet. E fundit nuk duhet të jemi egoist dhe për arsye të një pusi (Bunari) privat nuk mund ti lëmë banorët pa furnizim me ujë për pije. Ne nuk kemi qëllime dashakeqe, qëllimi është shumë human, fisnik dhe qytetarë.

z.Kastriot Shabani, DZHE: Përshëndetje. Përgjigje për asambleistin Mujota. Vlera komplet e projektit është 135 mijë euro. Kontrata parashihet për muajin Shtator. Vlera sivjet është 15.000 euro. Po bëjmë përpjekje me i kry punët për vlerën që e ka sepse afër jena dhe ishalla kushte atmosferike na mbajnë dhe kryhet edhe pjesa që është e paraparë për fshatin Mollopolc.


Pjesë tjera ku ka qenë më urgjente janë kry, tani janë duke u kryer në fshatin Petrovë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Meqenëse diskutime të tjera nuk ka, dhe përgjigjet tjera do ti merrni me shkrim, atëherë mbledhjen e Kuvendit e përfundoj në ora: 14:45h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi





Npi – 01/350 datë: 12.11.2024

PYETJE – PËRGJIGJE

NGA MBLEDHJA E -X- KUVENDIT MË 31.10.2024

z.Muhamet Ademaj: Kamë këto pyetje:

1. Pyetje për DPUKGJ-në, kur do të fillojë trotuari në rrugën “Skender Salihaj” dhe “Hyre Emini”?
Përgjigje:

z.Rexhep Gashi: Kamë këto pyetje:

1. Pyetje për DPUKLGJ-në, drejtor a është pranue teknikisht rruga Godanc-Gjyrvoc, saktësisht te rruga “Ibrahim Rugova” që kalon prej Godancit?
Përgjigje:

2. Dhe pyetja tjetër për DSHP-në, drejtor, këto pikët e stacionit të autobusave a janë pranuar teknikisht, sepse unë i di dy raste të cilat gjatë punësimit janë me xham të krisura, dhe nëse janë pranuar teknikisht si ka mundësi me u pranuar ashtu me xhama të krisura?
Përgjigje:

z.Besnik Seferi: Kamë këto pyetje:

1. Pyetje për DPUKLGJ-në, dua ta di a është e planifikuar edhe çështja e rrugës “Shefket Muhadini” po ashtu edhe rruga “Janina” në Davidovc?
Përgjigje:

2. Pyetje për DPUKLGJ-në, po ashtu e kam edhe një shqetësim që ka të bëjë me rregullimin e rrugës magjistrale Belinc-Carralevë ku vërtet u bë një kaos i madh aty dhe është demoluar ajo rrugë e nuk e di ku është problematika aty, ne e kemi për detyrë me shprehë si shqetësim sepse ajo rrugë po paraqet rrezik të madh, prandaj i rekomandoj drejtorisë të merr hapa konkret për rregullimin e kësaj rruge sa nuk është bërë ndonjë dëm i madh?
Përgjigje:

3. Pyetje për DPUKLGJ-në, pyetja tjetër ka të bëjë me planifikimin më konkretisht asfaltimin e rrugës “Lasgush Poradeci” në Muzeqinë në një segment te saj meqenëse, e kemi një bashkëqytetarë tonin Hasan Bajrami, i cili thot se ka bërë një kërkesë të vazhdueshme te drejtoria përkatëse për të cilën gjë duhet me ja dhënë një përgjigje se a do të bëhet apo jo?
Përgjigje:

4. Pyetje për DSHP-në, drejtor si është duke qëndruar situata e rregullores apo në Komunën e Shitimes?
Përgjigje:

5. Pyetje për DPUKLGJ-në, pyetja është se ku është dhe si është projekti i ujësjellësit të fshatit Rashincë?
Përgjigje:

znj. Adelina Beqaj: Kamë këto pyetje:

1. Pse ikën anëtarët e kuvendit të pozitës ku shkuan, a i dinë ata interesat e qytetarëve? Edhe kjo është pyetje e drejtuar pozitës, na krejt ktu jena?

Përgjigje:

2. Pyetje për DSHP-në, pse nuk po mirëmbahen trotuaret nëpër fshatra që janë të mbushura me bari?
Përgjigje:

3. Pyetja tjetër e përsëritur për DPUKGJ-në, qka po ndodhë me shtëpinë e të pames në fshatin Petrovë?

Përgjigje:

z. Reshat Mujota: Kamë këto pyetje:

1. Si shqetësim por edhe si kërkesë, për DKA-në, shkolla "Emin Duraku" paralelja në fshatin Belinc ka probleme me nxemjen dhe ka shqetësime të prindërve që ose me gjet një zgjidhje për nxemje me energji elektrike me ndonjë termo të rrymës ose me ba zgjidhje tjetër?

Përgjigje: znj. Yllkë Fejzullahu, DKA: Disa probleme që ka pasur shkolla në Belinc me ngrohjen, tashmë janë duke u rregulluar me kontratën e mirëmbajtjes që e kemi të kontraktuar në komunë.

2. Pyetja e dytë është për DSHP-në, pyetje konkrete Deponitë ilegale kanë evalou në gjitha tokat bujqësore sidomos në teritorin e Shtimes, ka banorë që edhe kanë bërë fjalë me njerzit duke hedhur mbeturina, jo vetëm qytetarë por ka edhe prej Kompanive?

Përgjigje:

3. Pyetjen tjetër e kam për DZHE-në, për disa rrugë të arave në fshatin Mollopolc, ende nuk kanë filluar dhe nuk ka asnjë lëvizje, kurë do të fillojnë punimet?

Përgjigje: z. Kastriot Shabani, DZHE: Përgjigje për asamblëistin Mujota. Vlera komplet e projektit është 135 mijë euro. Kontrata parashihet për muajin Shtator. Vlera sivjet është 15.000 euro. Po bëjmë përpjekje me i kry punët për vlerën që e ka sepse afër jena dhe ishalla kushte atmosferike na mbajnë dhe kryhet edhe pjesa që është e paraparë për fshatin Mollopolc. Pjesë tjera ku ka qenë më urgjente janë kry, tani janë duke u kryer në fshatin Petrovë.

znj. Albana Podvorica: Kamë këto pyetje:

1. Pyetje për DPUKGJ-në, te rruga "Skender Salihaj" afër shkollës "Emin Duraku" sa kam informata drejtor, ende nuk ka trotuar, kur do të bëhet rregullimi i trotuarit?

Përgjigje:

z. Lumni Amrush: Kamë këto pyetje:

1. Pyetje për DPUKGJ-në, unë kam pyetje konkrete, kur do të përfundojë palestra në Pjetërshticë?
Përgjigje:

2. Pyetje për drejtorinë e Arsimit, oborrin e shkollës, rrethojen e shkollës shkoj mandati asnjë mirëmbajtje nuk ja kanë bërë? E mos të flasim për brenda shkollës, kur do të bëhet rrethoja?

Përgjigje: znj. Yllkë Fejzullahu, DKA: Nuk është e vërtetë që nuk është punuar, sepse problemet që kanë qenë me rrjedhën e ujit tashmë janë sanuar në këtë shkollë dhe nuk ka më

një problem të tillë. Lidhur me rrethojat, asambleistit në fjalë disa herë i jam përgjigjur direkt në seancë lidhur me këtë çështje.

3. Pastaj kur do të përfundon një Kazermë Muze në fshatin Pjetërshticë?

Përgjigje:

4. Shkronjat e UÇK-së janë të parat në nivel vendi dhe tash janë bërë të vjetra, aty ka munguar gjithçka deri tash, kur do të rregullohen?

Përgjigje:

5. Kur do të bëhet pastrimi i lumit përmes fshatit që nuk është bërë asnjëherë?

Përgjigje:

6. Kur do të bëhet renovimi i atyre rrugëve siç është rruga "Idriz Ajeti" që e lidhë fshatin Pjetërshticë me fshatin Krojmir?

Përgjigje:

znj.Besartë Musliu-Spahija: Kamë këto pyetje:

1. Pyetja ime është për DSHP-në, për rrugën "Emrush" dhe rrugën "Selim Selimi" a do të bëhet ndriqimi në këto dy rrugë?

Përgjigje:

2. Pyetja e dytë është për DPUKGJ-në, pyetje nga banorët e lagjeve "Londra", "Berlini", "Parisi" e tjerë kur do të.....?

Përgjigje:

3. Pyetja tjetër është për DKA-në, pse nxënësit parashkollor të paraleles së ndarë në Belinc janë privuar të shkojnë në shkollën "Emir Duraku" në Shtime?

Përgjigje: znj.Yllkë Fejzullahu, DKA: Nuk janë privuar sepse askush nuk mund ta privojë dikë që ta vijojë shkollimin si një e drejtë elementare e bazike e çdo njeriu. Problemi ka qenë që disa prindër nga fshatin Belinc kanë insistuar që fëmijët e tyre ta vijojnë mësimin në Shtime dhe jo në Belinc ashtu siç është dashur të ishte sipas zonës ku jetojnë.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Përshëndetje, faleminderit Kryesues, për shkak të agjendës nuk mund të qëndrojë gjatë dhe desha me i dhanë disa përgjigje. Pyetje u bënë për ujësjellësin në fshatin Rashincë, ku më shumë ka tentim për me u politizu, se sa që ja don të mirën ujit dhe Rashincës. Ne kemi pas takim me disa persona që i kanë ngre shqetësimet e tyre gjoja për faljen e fondeve. E vërteta është që atje po ndërtohen përmes një projekti të përbashkët që e kemi Komuna e Shtimes me KRU "Prishtina", edhe dy Puse të reja dhe një impijant të grumbullimit dhe trajtimit të ujit, ku do të shtohet kapaciteti i ujit prej 20 litrave në sekond sa ishin shtohen edhe 20 litra për sekond, dhe kapaciteti i përgjithshëm do të jetë 40 litra për sekond, me qka për komplet fshatrat e rrafshit do të zgjidhet çështja e ujit të pijes. Ky është një lajm i mirë, i cili duhet me u prit mirë nga të gjithë. Këtë përzgjedhje dhe këtë projekt e ka bërë vetë KRU "Prishtina" si menagjuese e ujësjellësit me ingjinerët dhe ekspertët e vetë. Ne realisht nuk mund të diktojmë në këtë fushë kur ajo ka mbi 50 ekspert të ujit, dhe ne ti tregojmë se ku ka rezerva nëntoksore të ujit. Kte ua kam treguar edhe banorëve të fshatit Rashincë që janë shqetësuar. Ekspertët e kompanisë e thonë se uji do të merret në një thellësi nën 20 metra thellësi, e deri në 40 metra. Uji i ujësjellësit nuk ka asnjë lidhje me ujërat horizontale të ashtuquajtur sipërfaqësor të puseve private që mund të jenë nga 2 deri 8 metra. KRU "Prishtina" garantojnë të gjithë banorët e fshatit por edhe të tjerët se shtimi i kapaciteteve me puset

dhe impiantin nuk kanë asnjë ndikim lidhur me shqetësimet që i paraqesin ata, kështu që po e them që ta dëgjojnë edhe të gjithë qytetarët e fshatit Rashincë por edhe më gjerë. Ne e kemi për detyrë që të gjitha familjeve në komunën tonë me u sjellë atë që është elementare pra ujin e pijes. Ky është një projekt mbi 280 mijë euro. Po ashtu vitin e ardhshëm ne do të fillojmë me shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit nga burimi për ç'do familje të fshatit Pjetërshticë. Kështu që me këto fonde 500 mijë euro për fshatin Pjetërshticë dhe me 280 mijë euro për fshatrat e rrafshit, ne mendojmë që çështja e ujit të pijes që ishte problem i madh 25 vjeçar në komunën e Shtimes, përfundimisht do të zgjidhet. Edhe një herë u bëj thirrje të gjithë banorëve të fshatit Rashincë që mos të shqetësohen sepse ka analiza profesionale nga Injinerët që shpimet nuk do të ndikojnë fare në bunaret e tyre për të cilat po shprehin shqetësim. Nëse ka pakësim të ujit në bunaret e tyre kjo nuk vjen si pasojë e puseve të ujësjellësit por si pasojë e ndryshimeve klimatike që kanë ndikim në përgjithësi.

z.Rexhep Gashi: Kam këto pyetje:


1. Pyetje për Kryetarin, ku i kanë bërë këto matje, ku unë nuk dyshoj te matjet e shtetit, por unë dyshoj te periudha kohore që e kanë matë?

Përgjigje:

2. Pyetje për Kryetarin, a keni pas paraprakisht para se të fillojnë punimet për hapjen e këtyre puseve edhe hapja e kanaleve për shtrirjen e tubacionit për ujësjellës a keni pas takim me banorët e fshatit Rashincë?

Përgjigje:

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Unë nuk është se ja kam shikuar afatin e skadencës të atij projekti. Kështu që unë nuk e kam fare dyshimin në kapacitetet profesionale të KRU "Prishtina", sepse kjo është një nga KRU-të më të mëdha në Kosovë, i ka ekspertët e vetë. Ata e kanë një projekt të detajuar i cili tregon që rezervat ujore nëntokësore më të mëdha në komunën e Shtimes janë pikërisht në zonën të fshatit Gllavicë e Rashincë. Ju e dini që aty janë disa prona publike në të cilat do të bëhet shpimi. Sa i përket takimit me qytetarë, për hirë të vërtetës ne nuk kemi pas takim me qytetarë ekskluzivisht vetëm për këtë çështje, sepse kemi konsideru se ai është një projekt profesional i mirëfilltë i KRU-së në interes kryesor të banorëve atje, dhe këto puse ekzistuese edhe ato që do të bëhen të reja nuk e cenojnë në asnjë formë askend. Më vonë ka dalë ky shqetësimi nga banorët e fshatit Rashincë, por unë edhe një herë i garantoj jo mbi bazën e njohurive të mia por mbi bazën e sqarimeve që mi kanë dhënë ekspertët e KRU "Prishtina". Aty janë ujërat nëntoksorë ku uji do të merret nën thellësinë e 20 metrave dhe këto ujëra nëntoksorë nuk mund të ndikojnë ujrat horizontale që i mbushin pusët private të banorëve. Nëse shfaqet nevoja ne do të shkojmë dhe ti takojmë banorët një nga një, unë dy herë jam takuar me mbi 20 qytetarë të fshatit Rashincë, ku edhe ua kemi shpjegu kështu që e thash më parë. Kjo po bëhet në radhë të parë për të mirën e fshatit Rashincë, por pastaj edhe të gjitha fshatrave të rrafshit, madje edhe qytetit të Shtimes e më gjerë me lidhjen e gypave që do të bëhet. E fundit nuk duhet të jemi egoist dhe për arsye të një pusi (Bunari) privat nuk mund të lëmë banorët pa furnizim me ujë për pije. Ne nuk kemi qëllime dashakeqe, qëllimi është shumë human, e fisnik për qytetarë.




Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME-
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/ Mayor's Office

Data/Datum/Date:	20.11.2024
Nr./Br./No:	02/1191
Nga/Od/From:	Kryetarit të Komunës, z. Qemajli Aliu
Për/Za/To:	Kuvendi Komunal
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim për Vendim Paraprak për dhënien në shfrytëzim tëpronës komunale Zona Kadastrale Davidoc

Duke u bazuar në nenin 17 pika (a) dhe (c), dhe neni 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040; Nenin 4 dhe nenin 8 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092; Nenin 6 pika (3), neni 13 dhe 14 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe Planin Zhvillimor Komunal, Kryetari i Komunës bënë këtë Propozim – për Vendim Paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Për parcelën kadastrale me numër: P-72809023-00333-16 me sipërfaqe prej 2894 m² ,kultura – kullosë e klasit të -I- (parë) Z.K Davidoc, e shënuar në emër të Komunës së Shtimes.
Parcela e lartë shënuar është në listën e veçantë të pronave për dhënien në shfrytëzim. Periudha e dhënies në shfrytëzim është 99 vite.



CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72809023-00333-16

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	1745/24
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	20.11.2024 - 08:23
Komuna / Opština / Municipality:	SHTIME / ŠTIMLJE / SHITIME
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Davidoc / Davidovce
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	SHTIME / ŠTIMLJE / SHITIME

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R GIS U/R	Superficia Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-72809023-00333-16	PARCELË / PARCELA / PARCEL.	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	2894		16.05.2022	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i qatituar Mesto zvano Catted place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
UTRINË			16.05.2022	

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcesës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcesës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvaliteti Klase Quality Class	Superficia (m²) Površina (m²) Area
1	Bujëqesore / Poliprivredno / Agriculture	Kullësor / Pašunje / Pasture	Kullësor E Klasës I / Pašunak I Klase / 1st Class Pasture	2894

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID, No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Postanski kod Postal code	Hollësi të adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseëdhim individual / Individuealna Drzavina / Single possessor	Komuna e Shtimes	600258976	SHTIME / SHTIMLJE / SHTIME /		TAHIR SINANI	1/1		17.05.2022



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : SHTIME

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Davidoc

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m²
P-72809023-00333-16	Parcelë / Parcela / Parcel	2894




Shkalla/Razmera/Scale: 1:806

Punoi/Obradio/Created: Kadrije Zeqa

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:




Data/ Data/Date: 20.11.2024

Koha/ Vreme/ Time: 08:23:58



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME-
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/ Mayor's Office

Data/Datum/Date:	24.10.2024
Nr./Br./No:	02/1197
Për/Za/To:	Kuvendi Komunal - Shtime
Nga/Od/From:	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Drejt. Grejtalb Emin
Përmes/Preko/Through:	Kryetarit të Komunës, z. Gernajli Aliu
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim - Vendim për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d) dhe nenit 17, shkronja (c) të Ligjit për Vetqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 të datës 04 qershor 2008); Nenit 21 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092; Nenit 24 pika 1 i Rregullores së (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës: Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi përmes Kryetarit të Komunës së Shtimes, propozon Kuvendit të Komunës të japë në shfrytëzim afatgjatë pjesën e parcelës kadastrale nr P-72809093-03052-3 në sipërfaqe prej 2000 m²

Arsyetim: Bashkësia Islame dega në Shtime përmes kërkesës me nr 06-350/2-0030120/24 të datës 18.11.2024 të parashtruar në Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi ka kërkuar nga Komuna e Shtimës marrjen në shfrytëzim të pjesës së parcelës kadastrale nr P-72809093-03052-3 për sigurimin e paluajtshmërisë për ndërtimin e xhamisë e cila do të jetë në shërbim të komunitetit



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjetitë, Planifikimit Hapësinor dhe Infstrukturës / Ministarstvo Živane Sredine, Prostornog Planiranja i Infstrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72809093-03052-3

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

1759/24

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme kalavarija / Date and time of submission:

22.11.2024 - 08:33

Komuna / Opština / Municipality:

SHTIME / ŠTIMLJE / SHITME

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Shime / Štimlje / Shime

Zyra Kadastrale / Komunalne / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

SHTIME / ŠTIMLJE / SHITME

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vista jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vista imovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Supërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-72809093-03052-3	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	51212		01.10.2024	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i qendrës Mesto / Vaso Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
LIQI NDRIMAN			01.10.2024	

Numri i lëndës / Predmet / Case No. P-72809093-03052-3

Zyrtari përgjegjës / Odgovorne lice / Official person

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri i Ëtrij Number	Lloji i shfrytëzimit të parcesë Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcesë Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujëqesë Polioptivredinë Agriculture	Kullorinë Pasnjacë Pasture	Kullorë E Klasës 4 Pasnjak 4 Klase/4th Class Pasture	51212

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri i line Name	Nr. personal Lleni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drazvina / Single possessor	Komuna e Shtimes	600258976	SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME /		TAHIR SINANI	1/1		03.10.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : SHTIME


Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Shtime

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-72809093-01397-1	Parcelë / Parcela / Parcel	93306
P-72809093-03052-3	Parcelë / Parcela / Parcel	51212




Shkalla/Razmera/Scale: 1:5006

Punoi/Obradio/Created: Kadrije Zeqa
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 22.11.2024
Koha/ Vreme/ Time: 08:36:53





Nr. 81/24 Data 15.11.2024

DREJTUAR: KOMUNA E SHTIMES

Kryetarit të Komunës z. Qemajl Aliu dhe

Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi

K Ë R K E S Ë

Të nderuar,

Me anë të kësaj kërkeje, ju drejtohem në emër të Këshillit të Bashkësisë Islame në Shtime, me një kërkesë të rëndësishme për nevojat e komunitetit tonë. Kërkojmë ndihmën tuaj në sigurimin e një lokacioni për ndërtimin e një xhamie në rrugën Komandant Kumanova.

Ne kërkojmë një truall me sipërfaqe prej 40 deri në 60 ari, që do të shërbejë për ndërtimin e xhamisë, e cila do të jetë në shërbim të besimtarëve që jetojnë dhe punojnë në këtë zonë. Do të ishte e preferueshme që trualli të jetë i vendosur në një lokacion të përshtatshëm, në afërsi të rrugës kryesore, në anën e poshtme të shkollës së mesme "Naim Frashëri", në mënyrë që të mundësohet qasje e lehtë dhe komode për besimtarët që do ta frekuentojnë këtë xhami.

Arsyetim: Këshilli i Bashkësisë Islame beson se Komuna ka obligim ndaj qytetarëve të saj për t'u siguruar atyre mundësitë e nevojshme për kryerjen e obligimeve fetare, veçanërisht për namazin e xhumasë, i cili është një detyrim i rëndësishëm për besimtarët. Gjithashtu, ky lokacion do të shërbejë si një mundësi për punëtorët në parkun e biznesit dhe për ata që janë në lëvizje, për të realizuar obligimet e tyre fetare pa vështirësi. Xhamia Qendrore në Shtime në namazin e xhumasë nuk e përballon numrin e besimtarëve dhe më të vështirë e bënë edhe mungesa e parkingut.


Këshilli i Bashkësisë Islame është i angazhuar të hulumtojë mundësitë e financimit dhe donacioneve për ndërtimin e xhamisë, dhe mbështetje nga ana juaj për gjetjen e një trualli të përshtatshëm do të ishte shumë e vlerësuar.

Shpresojmë që kërkesa jonë të merret në konsideratë dhe presim një përgjigje pozitive.

Faleminderit për vëmendjen dhe mirëkuptimin tuaj.

Data: 15.11.2024

011/205-971



KRYETARI

Skender ef. Baftiu



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA SHTIME - OPŠTINA ŠTIMLJE - MUNICIPALITY OF ŠTIMLJE



Formulari per kerkese apo ankese

Drejtoria/Njesia

Data 18/11 2024

Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

Burim Rexhaj

Numri personal

2015228507

Adresa e vendbanimit

Shitime

E-mail Adresa

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

00000000

2. Mënyra e pranimit

Statusi i lëndës

Kërkesa

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

06-350/02-0030120/24

Afati i zgjedhjes

18/12/2024

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Kerkese per me ju siguru nje lokacion per ndertimin e nje xhamie

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi


Unë Burim Rexhaj vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkonit nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitur

Pranuar nga: vahide.ejupi






REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHITIME
MUNICIPALITY OF SHITIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHITIME

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mireqenie Sociale
Uprava za Zdravstvo i Socialnu Zastitu/Department of Health and Social Welfare

Data/Datum/Date:	22.11.2024
Nr./Br./No	07/358
Për/Za/To:	Kuvendit të Komunës së Shitimes
Nga/Od/From:	Mimoza Salihu Qeriqi, Drejtoreshë në DSHMS
Lënda/Predmet/Subject :	Informata për Kuvend - Janar - Tetor 2024



PËRMBAJTJA

- I . Drejtoria Komuna le e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Puna dhe aktivitetet e rregullta
- II. Sektori i Shëndetësisë të Kujdesit Primar Shëndetësor:
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “ Dr Vezir Bajrami”
- III . Sektori i Shërbimeve Sociale:
Qendra për Punë Sociale
- IV. Shërbimet Rezidenciale – Institucionale:
Shtrëpia e Komunitetit për Persona me aftësi të Kufizuar Mendore





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHITIME
MUNICIPALITY OF SHITIME

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Uprava za Zdravstvo i Socialnu Zastitu/Department of Health and Social
Welfare





RAPORTI JANAR-TETOR 2024

Në këtë informatë përshihen aktivitetet për periudhën janar - tetor të vitit 2024 nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si dhe tre sektorëve në menagjimin e saj.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si sektor me rëndësi të veçantë, që zhvillon veprimtarinë e vet në kuadër të komunës së Shinnës, ka realizuar planin e parapara sipas kalendarit të realizimit të tyre.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka zhvilluar aktivitete në të gjitha fushat e veprimtarisë me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor si dhe ngritjes së përgjithshme të cilësisë së jetës së qytetarëve të komunës, përfshirë këtu mbështetjen në fushat e shërbimeve sociale dhe më gjerë, ky raport mbulon periudhën janar-tetor 2024. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale gjatë muajve të fundit ka monitoruar me kujdes të gjitha njësitë si: QKMF, QMF, QPS dhe SHKSII.

Gjatë këtyre muajve të vitit 2024, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka realizuar një numër iniciativash kyçe, duke përfshirë:

- Takime me qytetarët e komunës së Shitinisë;
 - Takime të rregullta me drejtorët e qendrave QKMF, SHKSH, QPS;
 - Planimi i kërkesave nga qytetarët e komunës së Shitinisë;
 - Takime me organizata të ndryshme me karakter shëndetësor dhe social;
 - Takime me donatorë;
 - Monitorimi i mbarrëvajtës së punës të personelit shëndetësorë në QKMF dhe SHKSH;
 - Monitorimi i mbarrëvajtës së personelit në QPS;
 - Planifikimi i buxhetit për vitin 2025;
 - Shqyrtimi i kërkesave nga QKMF, QPS, SHK;
- Bashkëpunim me: AQH accessible quality healthcare).

Punët e përfunduar:


1. Shqyrtimi i kërkesave për suveccionet që ofron komuna Shitine, konkretisht Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
2. Kërkesave të ndryshme që kanë të bëjnë me sigurimin shëndetësor në Republikën e Kosovës (vërejtje).
3. Përpilimi i aktivendimeve për nënat lehona dhe aktivendimet për vazhdimin e qëndrimit të rezidentëve në qendrën rezidenciale (shëpimë e komunitetit) në bazë të kërkesës së QPS-ve, të komunave të ndryshme në varësi nga cila komunitet vijnë banorët.
4. Hartimi i raporteve financiare dhe administrative në funksionimin e organizatës buxhetore.
5. Përfundimin e të gjitha lëndëve të pranuar nga qytetarët në sistemin e intanet-it të cilat shqyrtohen (të miratuara, të refuzuara, të anulhuara etj).



Gjithësejtë Kërkesat për subvencione për përditësimin e faktorit 2024 në Drejtësi dhe Shëndetësi dhe Mbrojtjes Sociale			369	
1.	Kërkesa të nënave lebona dhe përfituese.	234	33350€	
2.	Kërkesa të ndryshme për përkrahje shëndetësore dhe strehim banim.	54	15500€	
3.	Kërkesa të OJQ-ve dhe përfituese.	8	20000€	
4.	Kërkesa të familjeve strehuese e të cilat janë përfituese.	3	1800€	
5.	Kërkesa ne shqyrtim nga komisioni	70		

BUXHETI

Buxheti 2024



KONTRATA E LIDHURA ME PROKURIM

Kontrata në QKMF;

Kontrata blerje dhe instalimi i pompës termike;

Kontrata blerje e rrobales industriale;

Kontrata furnizim me barra dhe material shpenzues;

Kontrata furnizim me material të stomatologut;

Kontrata me pajisje speciale mjekësore;

Kontrata oksigjen;

Kontrata hemodializë;

Kontrata për laborator;

Kontrata për mirmbajtje të veturës;

Kontrata për RTG.

Kontrata SHKSH dhe QPS


- ▢ Kontrata furnizim me artikuj ushqimorë;
- ▢ Kontrata e mirëmbajtjes;
- ▢ Kontrata furnizim mjekësore;
- ▢ Kontrata shërbime shëndetësore;
- ▢ Kontrata artikuj të ndryshëm;
- ▢ Kontrata furnizim me mish;
- ▢ Kontrata blerje e gjenaratorit;
- ▢ Kontrata furnizimi;
- ▢ Kontrata mirëmbajtjes;
- ▢ Kontrata riparim l veturës;
- ▢ Kontrata blerje kallldajes.

Kujdesi parësor shëndetësor

- ❖ Komunitat janë përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre.
- ❖ Komunitat obligohen të zbatojnë me prioritet masat prioritare të promovimit dhe parandalimit në kujdesin shëndetësor.
- ❖ Kujdesi parësor shëndetësor sigurohet dhe zbatohet brenda kornizës shërbimeve të njëkësishë familjare.


MJEKËSIA FAMILJARE DHE SFIDAT NË KOMUNËN E SHITES

- Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që banorëve të komunës t'u ofrojnë kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës, të bazuar në të dhëna shkencore dhe efikase, përmes caktimeve të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për pacientët në sistemin shëndetësor, dhe njëherësh pikë referuese për specialistët konsultat në kujdesin parësor dhe në nivele tjera të kujdesit shëndetësor (dytësor dhe tretësorë prej ç'do qytetari dhe banori do të kërkojë të përcaktohet për një mjek familjar. Çdo qytetar dhe banor ka të drejtë të përzgjedhë mjekun familjar në komunën tonë, brenda zonës së përshirjes të përcaktuar nga komuna.
- Kujdesi shëndetësor zbatohet në institucionin shëndetësor, ose në shtëpi të qytetarit, ose të banorit atëherë kur qytetari ose banori ka nevojë për kujdes shëndetësor emergjent edhe për kundër asaj që nuk kemi shërbim të patronazhit.
- Objektet ekzistuese janë në gjendje të mirë që të ofrojnë shërbime cilësore për qytetarët e komunës sonë me përfshirjen të Emergjencës në të cilën do të kryhen disa ndërhyrje të nevojshme.
- Këtë vit kemi arritur që shërbimin Radiologji, Gjinjekologji dhe Pediatri t'a funksionalizojmë në QKMF.
- Po ashtu stafi është i kompletuar sipas nevojave të parapara me ligj në kujdesin parësor shëndetësor, këtë vit gjithashtu synojmë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të të gjithë stafit.



QKMF	QMF
1. Shitine	1. Pletëshitë
	2. Murrësi
	3. Petrovë
	4. Godancë i Ulët

Kujdesi parësor shëndetësorë në shtime përbëhet nga:




Në QKMF Shitme "Dr. Vezir Bajrami" janë gjithsej këto njësi:

Mjekësia Familjare	
Shërbimi Emergjent	
Internisti	
Shërbimi publik	
Keshillimorja	
Shërbimi oral dhe preventiv	
Shërbimi i diagnostikës	
Laboratori	
Banimatorja	
Administrata	

Gjithashtu në kuadër të marrëveshjes me Caritas
Kosova kemi të angazhuar edhe specialistët si:

- Radiologun
- Ginekologun dhe
- Pediatrin

ORGANOGRAMI I QKMF " DR. VEZIR BAIRAMI" SHITME



Gjatë vitit 2024 në periudhën kohore Janar – Tetor 2024 në Qendërën Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Vezir Bajrami” në Shitme dhe në QMF-
Muzeqinë, QMF-Petrovë, QMF-Pjeterishitë QMF-Godane, janë kryer gjithësej:

117316-Vizita mjekësore
268942-Shërbime shëndetësore.



Këto të dhëna janë të paraqitura më poshtë në formë tabelare.

Gjithsej - Vizita Mjekësore për periudhën Janar - Tetor 2024 në QMF, QMF, URGJENCË		
1.	Vizita Mjekësi Familjare	35203
2.	Vizita - Urgjencë	44764
3.	Vizita Stomatologjike	3961
4.	Vizita Kujdesi Pallativ	2565
5.	Vizita Radiologjike & Rtg	5015
6.	Vizita-Internisti	1668
7.	Vizita Nën dhe Fëmijë	685
8.	Vizita në QMF Muzeqinë	5540
9.	Vizita në QMF Pjeterishitë	2618
10.	Vizita në QMF Petrovë	1611
11.	Vizita në QMF Godane	819
12.	Vizita në Vaksinim	3483
13.	Vizita në Laborator QKMF+QMF	8425
14.	Vizita sistematike	959
TOTALI I VIZITAVE MJEKËSORE		117316

Shërbime shëndetësore


Gjithësej - Shërbimet Mjekësore për periudhën Janar - Tetor 2022 në QKMF QMIF, IUKGJENÇE	
1.	Gjithësej shërbime në Mjekësi Familjare
2.	Gjithësej shërbime në Urgjencë
3.	Gjithësej shërbime në Stomatologji
4.	Gjithësej shërbime në Baranatore
5.	Gjithësej shërbime në Radiologji & Rg
6.	Gjithësej shërbime në Laborator QKMF dhe Qmf
7.	Gjithësej shërbime në Manograli
8.	Gjithësej shërbime QMF Muzeqinë
9.	Gjithësej shërbime QMF Pjetershucë
10.	Gjithësej shërbime QMF Petrovë
11.	Gjithësej shërbime QMF Godane
12.	Gjithësej shërbime në Vaksinim
13.	Gjithësej shërbime Nëna dhe Fëmijë
14.	Gjithësej shërbime në Këshillimore
15.	Gjithësej shërbime infermieristike
16.	Gjithësej shërbime në Kuidesin Palliativ
TOTALI SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE	
	268942

PAISJET E REJA NE QKMF



Që nga vendosja e manograftit në QKMF Dr. Vezir Bajrami
jan kryer 110 manografti faldas gjate muajit tetor, si
dhe me udhezimin e ri qytetarit e Shitimes
kete sherbim do ta marrin gjithmon faldas.

Mirëqenia sociale



Gjithësi – Shërbimet Sociale – për personat e famur – Tetor 2024		
1.	Fëmijë të braktisur	-
2.	Fëmijë të mbetur pa përkujdesje	-
3.	Fëmijë vetëm tek njëri prind	-
4.	Kontakte me fëmijë të zhvilluar në QPS-të	6 raste
5.	Raste të adoptimit	-
6.	Fëmijë me strehim në familjet shprehëse	1 rast i vjetër
7.	Fëmijë të keqtrajtuar	-
8.	Fëmijë me sjellje delikvente	53 raste
9.	Raste të dhunës në familje	34 raste
10.	Mardhënie të rregulluara familjare	3 raste
11.	Mbrojtje të personave të moshuar	-
12.	Fëmijë me aftësi të kufizuara	7 raste
13.	Raste të tjera	130
Totali i rasteve të shërbimeve sociale		233

Divizioni asistencës sociale ka vazhduar punën sipas planit dhe orarit të parapare me ligjin e sus-it.

Shfrytëzuesit e ndihmës sociale për vitin 2024:

Muaji	
Janar	264
Shkurt	256
Mars	250
Prill	247
Maj	249
Qershor	244
Korrik	247
Gusht	241
Shtator	236
Tetor	233


Në janar të vitit 2024 ishin 264 familje në skemën
e ndihmës sociale ndërsa në tetor të këtij viti kemi 233 raste.

Shtëpia e Komunitetit-Shitime

- ▣ Përkthim i përgjithshëm- Në Shtëpinë e Komunitetit në Shitim, ofrohen shërbime të ndryshme ndaj 11 klientëve, me një staf të punëtorëve prej 13 personave (10 të rregulltë dhe 3 punëtorë të kontraktuar me Caritas Kosova), me orare të ndryshme kohore, duke iu përshatur nevojave shërbëse dhe duke iu ofruar shërbim klientëve 24 orë.
- ▣ Për këtë vit, tek shpenzimet kapitale kemi planifikuar që të ndërtojmë një pushimore në oborrin e Shtëpisë, është bërë si zakonisht me procedura prokurimi
- ▣ Aktivitetin rekreativ në Prevalle me rezidentë e kemi planifikuar të realizohet në dy faza. Aktiviteti është realizuar sipas planifikimit, dhe konsideroj se ka qenë i suksesshëm.
- ▣ Aktivitetet rekreative me klientë nuk kanë mundur gjatë festave, gjithashtu aktivitetet në ambientin natyror në Jezerc, vizita nëpër familje të rezidentëve etj.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Nr.prot. 11/220

Datë 15.11.2024

**PROCESVERBAL NGA KONSULTIMI PUBLIK ME QYTETARË PËR DRAFT-
RREGULLOREN PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR VITIN 2025**

E mbajtur më datë 15 nëntor 2024 (e premte), nga ora 14:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës së Shtimes

Pjesëmarrës në takim: Besik Ahmeti, Hysen Hoxha, Ibrahim Demiri, Muhamet Qeriqi, Ymri Behluli, Gentiana Mehmeti, sanie Sadiku, Arben Topalli, Albulenë Emini, Ilir Fejzullahu, Idriz Mehmeti, Idajet Rexhepi, Merita Emini, Bardhyl Rushiti, Grejtalb Emini, Adnan Ademi, Arben Deliu, Visar tershani, Vlora Hyseni.

Mbledhja është hapur nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Besnik Ahmeti, i cili para të pranishmëve prezantoi qëllimin e konsultimit publik.

Takimin e fillon Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Besnik Ahmeti i cili përshëndet të pranishmit ku thote se fillimisht rregullorja nuk ka ndryshuar, por ne presim nga qytetarët që gjatë konsultimit të marrin ndonjë kërkesë e cila do të ishte e mirseardhur për qytetarët e Komunës së Shtimës ku ne munde te bëjmë ndryshime të shtojmë ndonjë pikë ose të hiqet diçka e cila nuk është në të mirë të qytetarëve.

Fjalën e merr Idajet Rexhepi ku i cili kërkonë të bëhet klasifikimi i mbeturinave, si dhe të rishikohet tarifat e tregut si dhe të hapsirave publike të korigjohen dhe të dergohen në Kuvend.

Albulena Emini nga Drejtoria për Sherbime Publike thotë se kemi të rregulluar qeshtjen e mbeturinave ku dhe kemi Rregullore, personi në fjale kërkon që të hiqen Pëlqimet higjeniko- sanitare të cilat janë në këtë Drejtori sepse nuk kemi zyrtar (Inspektor) për lëshimin e këtij dokumenti pasi që Inspektori ka kaluar në nivel Rajonal dhe e njeta kërkon që neni 6 ku thot për Lejen Mjedisor Komunal të kaloj nga Drejtoria për Planifikim Urban, Kadaster dhe Gjeodezi të kalojne në Sherbime Publike.


Ndër të tjera fjalën e merr qytetari Hysen Hoxha ku thotë se taksat janë të mirseardhura por kërkon që puna të kryhet mirë dhe me taksat që i cakton kjo Rregullore të mirmbahen ato, i njëjti kërkon që të formohet një fondë emergjent i cili do të ishte i nevojshem që nëse kemi ndonjë dëmtim të rrugës apo ndonjë prishje të ndonjë gypi puna të kryhet menjëher e mos të presim ende procedura për projekte se shkonë kohe me e gjatë deri sa të rregullohen.

Keto ishin dhe kërkesat e qytetarve të cilat do të mirrn parasysh.

Fjalën e merr Drejtori i Drejtoris për Buxhet dhe Financa Besnik Ahmeti i cili tha se do të shikohet që kërkesat e qytetarëve të hynë në këtë rregullore dhe mbyll debatin.

Takimi përfundoi në ora 15:10

Procesmbajtës:
Merita Emini




Kryesuesi i mbledhjes
Besnik Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Nr.prot. 07/359

Datë 15.11.2024

**PROCESVERBAL NGA DISKUTIMI PUBLIK ME QYTETARË PËR STRATEGJINË
PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË KOMUNËN E
SHTIMES 2025-2028**

E mbajtur më datë 15 Nëntor 2024 (e premte), në Hotel "Venus", duke filluar nga ora 10:00

Pjesëmarrës në takim: Faruk Beqa, Mimoza Salihu-Qeriqi, Besnik Ahmeti, Valon Januzi, Lirim Hamili, Tafë Fazliu, Zenel Muhadini, Ilaz Kadrijaj, Diellza Salihu, Yllka Bajrami, Feriz Brahimi, Sahadete Sopa, Mervete Hasani, Reshat Gashi, Emin Rexhaj, Ferdi Rexhaj, Gazmend Behluli, Besarta Smajli, Xhevdet Smajli, Ragip Fejzullahu, Bukuri Fejzullahu, Agim Emiri, Granit Emiri, Shkelzen Hajdini, Vlora Hyseni, Albion Shabani.

Mbledhja është hapur nga nënkryetari i Komunës së Shtimes Faruk Beqa i cili para të pranishmëve prezantoi Draft-Strategjinë dhe Planin e Veprimit.

z.Faruk Beqa (Nënkryetar i Komunës së Shtimes): Strategjia dhe Plan i Veprimit (SPV) për Persona me Aftësi të Kufizuara (PAK) është dokument me prioritet për komunën e Shtimes e cila do të përmbushë nevojat e PAK

Dokumenti synon të ndërtoj resurset, mekanizmat dhe infrastrukturën, si dhe të përcaktoj kompetencat për të krijuar mundësi për personat me aftësi të kufizuara të përfitojnë maksimumin nga aftësitë e tyre në mënyrë të barabartë.

Në muajin Korrik të vitit 2024, është themeluar i Grupi Punues (GP) ku janë përfshirë: Zyra e kryetarit, Drejtoritë: Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (SHMS), Arsimit, Financave, Handikos, Kryqi i Kuq, Shoqata e të verbërve (SHV) zyrat në Shtime, dhe përfaqësuesit e Shoqërisë Civile (SHC).

Në takimet me drejtorët dhe takime me GP është bërë analiza e gjendjes janë përcaktuar objektivat dhe identifikuar nevojat të cilat janë inkorporuar në plan të veprimit.

Po ashtu janë identifikuar resurset, përgjegjësit dhe afatet kohore të zbatimit të aktiviteteve përkrahur me buxhetin komunal.

SPV për PAK 2025-2028, është hartuar bazuar në modelin e Drejtorisë për Shëndetësinë dhe Punë Sociale (DSHPS) të Komunës së Lipjanit, si dhe me takimet e rregullta është mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Në hulumtimet botërore është publikuar se rreth 1.3 miliardë njerëz përjetojnë aftësi të kufizuara të konsiderueshme. Kjo përfaqëson 16% të popullsisë së botës, ose 1 në 6 prej nesh.

Në komunën e Shtimes janë identifikuar rreth 300 PAK.

Konsiderojmë se duhet angazhim dhe punë adekuate për gjithë përfshirje, qasje dhe respektim të të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK)

Konsultimi i vazhdueshëm me aktorët relevant

Kemi ndarë detyrat të disa nga aktorët në GP

Kemi bërë mbledhjen e të dhënave

Kemi bërë analizën e situatës

Me vendim unanim të Kuvendit të Komunës (KK), dokumenti është dërguar për dëgjim publik

Sot është dita kur marrim sugjerime, këshilla nga ky takim dhe pas kësaj, dokumenti do të dërgohet në KK për miratim final

Qëllimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit është që Komuna e Shtimes të siguroj një mjedis të barabartë dhe gjithëpërfshirës për PAK

Garantimin e të drejtave të barabarta

Përmirësimin e qasjes në shërbime dhe mundësi të barabarta në të gjitha sferat e jetës, në shërbimet shëndetësore, arsim, punësim dhe të drejtat tjera themelore njerëzore

Qëllimi themelor është të promovohet, avancohet dhe të mundësohet e të mbrohet përfshirja dhe integrimi i plotë i personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore dhe ekonomike

Strategjia komunale për Personat me Aftësi të Kufizuara në komunën e Shtimes, është hartuar në përputhje me:

Strategjisë nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës 2013–2023

Planit të veprimit për zbatimin e strategjisë nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës 2013–2015 si dhe

Duke i konsultuar të gjitha dokumentet tjera vendore dhe ndërkombëtare të cilat e rregullojnë çështjen e personave me aftësi të kufizuara

Kemi edhe shume për të thënë sa i takon kësaj strategjie, por tani fjalën ja kaloj drejtoreshës së shëndetësisë në Komunën e Shtimes, Mimoza Salihu-Qeriqi.

Mimoza Salihu-Qeriqi (Drejtoreshë e Shëndetësisë-Komuna e Shtimes): Përsëritje për të gjithë ju të pranishëm dhe falemnderit që sot jeni prezent këtu me ne.

Strategjia është e strukturuar në pesë 5 fusha të cilat përfshijnë të gjitha aspektet kryesore të jetës së Personave me Aftësi të Kufizuara me fokus në fushat si në vijim: Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Punësim, Arsimit, Pjesëmarrja në vendimmarrje dhe Qasja e plote duke përfshirë informimin, komunikimin dhe pjesëmarrjen.

Objektiva Strategjike 1: Avancimi i mëtutjeshëm i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.

Objektiva Strategjike 2: Sistem funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenie dhe siguri sociale, si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Objektiva Strategjike 3: Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara.

Objektiva Strategjike 4: Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara në vendimmarrje.

Objektiva Strategjike 5: Krijimi i qasjes së plotë, informimi me kohë dhe promovimi i shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.

Avancimi i mëtutjeshëm i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.

Përmes kësaj objektive strategjike, Komuna e Shtimes synon të përmirësojë shëndetin publik duke avancuar ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe duke i përshtatur ato me nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

Promovimi dhe edukimi shëndetësor zë një vend shumë të rëndësishëm në këtë strategji. Përmes promovimit dhe edukimit shëndetësor Komuna e Shtimes synon përmirësimin e shëndetit dhe jetës së të gjithë qytetarëve të sajë pa përjashtim.

Në kuadër të kësaj strategjie janë parapare përmirësimi i qasjes fizike në institucionet shëndetësore dhe në shërbime, ofrimi i shërbimeve të duhura shëndetësore duke përfshirë edhe vizitat në shtëpi për pacientet të shoqëruar me vështirësi në lëvizje si dhe vizitat dhe shërbimet e paliativitetit.

Në kuadër të shërbimit vizitat për nenat dhe fëmijët deri në moshën 3 vjeçare, synojmë zbulimin e hershëm dhe identifikimin e aftësisë së kufizuar prej kohës prenatale, natale dhe në fazat e mëvonshme. Po ashtu, planifikohet të organizohen kampanja vetëdijësuese për identifikimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe ofrimin e shërbimeve të duhura.

Sigurimi i gjithë përfshirjes sociale dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Përmes objektivit të dytë strategjik synojmë të krijojmë një ambient shoqëror me mundësi të barabarta dhe shërbime sociale gjithëpërfshirëse të cilat i përgjigjen nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

Me këtë dokument ne angazhohemi që shërbimet sociale të jenë jo vetëm të disponueshme por të qasshme, efektive dhe të qëndrueshme.

Me tutje, përmes këtij objektivit, kemi për qëllim të përmirësojmë qasjen, të bëjmë ngritjen e resurseve dhe kompetencave të shërbyeseve civil dhe publik për realizimin e të drejtave të PAK në njërin dhe të PAK në anën tjetër për të shfrytëzuar të drejtat e tyre dhe për të siguruar mirëqenien e tyre.

Faruk Beqa: Nëse ndokush nga të pranishmit don që të marrë fjalën?

Xhevdet Smajli (Shoqata e të verbërve):Kërkoj kushte më të mira për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara që deri më tani nuk i kemi pasur, si rregullim të trotuareve, semafor akustik etj.

Tafë Fazliu (Hendikos): Shpesh herë nuk kemi mbështetje dhe nuk është në rregull që një personi me aftësi të kufizuar që tani edhe e kemi të pranishëm këtu, ti ndalet marrja e pensionit, e kjo i ndodh që 5 muaj.

Valon Januzi: Oborri i Komunës së Shtimes ka gjithësej 10 vendparkingje të cilat nuk janë të specifikuara, por për personat me aftësi të kufizuar, ju premtoj që do t'i kemi parasysh kërkesat e tyre.

Shkelzen Hajdini (Drejtori i Shendetësisë-Komuna e Lipjanit): Ju falemnderit për ftesën të cilën e mora me knaqësi! Dua të ju them me shumë bindje, se kështu duhet të bëhet një document, e përgëzoj nënkryetarin Beqa për punën e bërë por duhet të kërkohej kontribut nga të gjithë për ndihmë personave me aftësi të kufizuar. Jeni komuna e dytë në Kosovë që tani keni një document të till, document ky që synon të përmirëson qasjen e këtyre personave në sfera të ndryshme.

Pascale Roussy (Drejtoreshë e Departamentit të Demokratizimit-OSCE): Jam shumë e lumtur që sot jam këtu me ju dhe të ju përgëzoj për punën që keni bërë në realizimin e kësaj strategjie i cili është një document shumë i rëndësishëm e kjo është meritë e të gjithë grupit punues. Një e mirë tjetër është që këtu shohim edhe bashkëpunimin ndërkomunal por edhe ndërpartiak

Do të vazhdojmë të mbështesim komunën tuaj në zbatimin e kësaj strategjie.


Faruk Beqa: Ju falemnderit të gjithëve! Dua të shtoj edhe një gjë, gjatë hartimit të kësaj strategjie kam mbështetjen e plotë të stafit dhe dua t'ju premtoj që një dokument si ky nuk do të mbulohet nga pluhuri por do të përkushtohemi që të realizohet sepse edhe e kemi obligim.

Ju falenderoj edhe njëherë për pjesëmarrjen tuaj dhe mirë u pafshim në takime të tjera.

Takimi përfundoi në ora 11:50

Procesmbajtëse
Vlora Hyseni

[Signature]



Kryesuesi i Mbledhjes
Faruk Beqa

[Signature]